



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 4479 Prot.

Tiranë, më 9.11.2023

Lënda: Kërkesë për riklasifikimin e pagave të 3 pozicioneve të KPK-së dhe unifikimin e tyre me organet kushtetuese të rivlerësimit kalimtar KPA dhe IKP, në vijim të VKM-së nr. 325/2023

Drejtuar: KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
ZNJ. LINDITA NIKOLLA, KRYETARE E KUVENDIT

KOMISIONIT PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE
DHE TË DREJTAVE TË NJERIUT
ZNJ. KLOTILDA BUSHKA, KRYETARE E KOMISIONIT

E nderuar znj. Nikolla,
E nderuar znj. Bushka,

Në vijim të diskutimeve të projektbuxhetit për vitin 2024 për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, sikurse edhe për dy institucionet e tjera të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, KPK-ja parashtron të njëjtën kërkesë për unifikimin e 3 pozicioneve të punës në personelin administrativ të tij, krahas kërkesës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe Institucionit të Komisionerëve Publikë.

Si rrjedhojë e ndryshimeve ligjore e nënligjore që pësoi i gjithë sistemi i pagave të administratës publike, pas Vendimit nr. 35/2022 të Gjykatës Kushtetuese dhe në vijim të Vendimit nr. 36/2022, datë 12.5.2022, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit", në përmbajtje të kësaj VKM-je, përcaktohet detyrimi për rishikimin e strukturave dhe riklasifikimin e pagave nga çdo institucion.

Propozimi për klasifikimin e pagave në projektvendimin "Për disa ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 36/2022" nuk e ndryshon (nuk e rrit) numrin e përgjithshëm të personelit prej 76 vetash.

1

Për sa më sipër, bashkëlidhur ju dërgojmë propozimin për miratimin e projektvendimit “Për disa ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 36/2022, “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, sipas relacionit dhe Lidhjes 1, bashkëlidhur tij.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KRYETAR
Roland ILIA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Relacion i propozimit të projektvendimit “Për disa ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 36/2022, “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, sipas relacionit dhe Lidhjes 1, bashkëlidhur tij

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) është institucion i pavarur kushtetues, i krijuar në mbështetje të nenit 179/b të Kushtetutës, si dhe të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Me Vendimin nr. 36/2022, datë 12.5.2022, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni ka në përbërjen e tij 76 punonjës.

Sa i takon punonjësve administrativë, pagat e të cilëve referohen në vendimin që trajton pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucionet e pavarura, klasat e pagave të përcaktuara në vendim për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë si më poshtë:

Sekretar i Përgjithshëm	I-a
Drejtor	II-b
Përkthyes	II-b
Koordinator për median dhe marrëdhëniet me jashtë	III-a
Specialist	III-b
Sekretar i Kryetarit - Sekretar në kabinetin e Kryetarit të Kuvendit	

Pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr. 35/2022 të Gjykatës Kushtetuese dhe në vijim të **Vendimit nr. 36/2022, datë 12.5.2022**, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, në **Vendimin nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave**, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera në pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucioneve të administratës publike”, **përcaktohet detyrimi për rishikimin e strukturave dhe riklasifikimin e pagave nga çdo institucion.**

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.5.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera në pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucioneve të administratës publike”, i cili ka shfuqizuar VKM-në nr. 187, datë 3.3.2017, në kreun II – Kategoritë, klasat dhe elementet përbërëse të pagës bruto mujore, ka bërë një organizim të ri të klasave, pagës për pozicion dhe elementet përbërëse të pagës bruto mujore.

Në kreun IV të vendimit ngarkohen institucionet, pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi, të propozojnë ndryshimet në strukturat dhe organikat ekzistuese për përshtatjen e tyre sipas klasave të pagave të përcaktuara në këtë vendim, duke bërë lidhjen midis klasave ekzistuese dhe atyre të reja.

Riklasifikimi i pagave për punonjësit administrativë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ndjek strukturën organike të KPK-së dhe paraqitet si më poshtë:

Nr.	Funksioni organik	Paga aktuale Sipas VKM nr. 187		Paga e propozuar Pas VKM nr. 325/2023	
		Klasa e pagës	Paga për pozicion (lekë në muaj)	Klasa e pagës	Paga për pozicion (lekë në muaj)
1	Sekretar i Përgjithshëm	I-a	150 500	I-1	235 000
2	Drejtor	II-b	107 000	I-4	180 000
3	Përkthyes	II-b	107 000	II-1	155 000
4	Kordinator për median dhe marrëdhëniet me jashtë	III-a	86 500	II-1	155 000
5	Specialist	III-b	65 200	IV-1	80 000
6	Këshilltar pranë Mbledhjes së Komisionerëve dhe Kryetarit		73 500	II-1	155 000

Gjithashtu, pjesë e këtij propozimi është edhe ndryshimi i emërtesës së një pozicioni ekzistues pune, në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, nga “Specialist financë-prokurime” në emërtesën “Specialist financë-buxheti”. Ky ndryshim nuk ka asnjë efekt financiar në buxhetin e Komisionit dhe asnjë ndryshim të numrit të përgjithshëm të punonjësve të përhershëm të KPK-së prej 76 vetash. Emërtesa e re e këtij pozicioni dhe tabela e mësipërme e riklasifikimit të tre pozicioneve Drejtor, Koordinator për median dhe marrëdhëniet me jashtë, si dhe këshilltar pranë Mbledhjes së Komisionerëve dhe Kryetarit, pasqyrohen në Lidhjen 1.

Referuar sa më sipër, në kushtet kur ndryshimi që kërkohet në vijim të VKM-së nr. 325, datë 31.5.2023, i riklasifikimit të pagave për punonjësit administrativë të Komisionit, sjell nevojën për ndryshim të Vendimit të Kuvendit nr. 36/2022, si dhe në respektim të piramidës së pagave

në dy drejtoritë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (që janë “Drejtor” dhe pjesa tjetër “Specialistë”), vlerësojmë se:

Përveç përshtatjes sipas klasave të reja të pagave nevojitet të unifikohen paralelisht këto pozicione pune të administratës së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me ato të organeve të tjera kushtetuese të rivlerësimit kalimtar, Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe Komisionerit Publik.

Konkretisht, ndryshimet që propozohen janë si vijon:

1. Riklasifikimi i pagës për funksionin organik “Drejtor” nga klasa II-1 në klasën I-4.
Efekti financiar vjetor i këtij ndryshimi llogaritet në vlerën 800,000 lekë.
2. Riklasifikimi i pagës për funksionin organik “Kordinator për median dhe marrëdhëniet me jashtë” nga klasa III-1 në klasën II-1
Efekti financiar vjetor i këtij ndryshimi llogaritet në vlerën 576,000 lekë.
3. Ndryshimi nga pozicioni “Sekretar i Kryetarit” në pozicionin “Këshilltar pranë Mbledhjes së Komisionerëve dhe Kryetarit”
Efekti financiar vjetor i këtij ndryshimi llogaritet në vlerën 1,042,000 lekë.

Efekti total shtesë për vitin 2024, duke marrë parasysh ndryshimet e mësipërme, për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit është 2,418,000 lekë.

Bashkëlidhur këtij relacioni është edhe Lidhja 1 e projektvendimit “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 36/2022, datë 12.5.2022, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KRYETAR
Roland ILIA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

PROJEKT-VENDIM

PËR

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 93/2017 “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, ORGANIKËS DHE KLASIFIKIMIT TË PAGAVE TË PERSONELIT TË KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT”, TË NDRYSHUAR ME VENDIMIN 36/2022 TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 78 dhe nenit C të Kushtetutës, si dhe të neneve 18, pika 1, dhe 29 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

- I. Miratohen ndryshimet në strukturë, organikë dhe klasifikimin e pagave të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
- II. Organika dhe klasifikimi i pagave të personelit është sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
- III. Struktura organizative është sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.
- IV. Pikat IV dhe V të Vendimit nr. 36/2022 datë 12.5.2022 të Kuvendit të Shqipërisë mbeten në fuqi të pandryshuara.
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Lindita NIKOLLA

Miratuar në datën ____ . 11.2023

**ORGANIKA DHE KLASIFIKIMI I PAGAVE
TË KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT**

FUNKSIONI ORGANIK	Klasifikimi i pagës	Numri
		(2)
I. KRYETAR	G3*	1
Këshilltar pranë Mbledhjes së Komisionerëve dhe Kryetarit	II-1	1
II. KOMISIONERËT	G3*	(11)
		(36)
III. NJËSIA E SHËRBIMIT LIGJOR		
Këshilltarë jurist	80% e pagës G3*	24
Këshilltarë ekonomistë	80% e pagës G3*	12
IV. SEKRETAR I PËRGJITHSHËM	I-1	(1)
V. DREJTORIA E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME MEDIAN DHE PUBLIKUN		(15)
Drejtor	I-4	1
Specialist sekretarie gjyqësore	IV-1	6
Specialist jurist	IV-1	2
Specialist për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve	IV-1	2
Përkthyes	II-1	2
Koordinator për median dhe marrëdhëniet me jashtë	II-1	1
Specialist pritje me popullin	IV-1	1
VI. DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE		(11)
Drejtor	I-4	1
Specialist financë/buxhet	IV-1	2

Specialist i burimeve njerëzore	IV-1	1
Specialist IT **	IV-1	1
Specialist protokoll/arkivi ***	IV-1	2
Magaznier	VI	1
Punonjës pastrimi	II	2
Shofer/Korrier	V	1
Total		76

Shënim:

* Sipas ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

** Punonjësit në pozicionin e specialistëve të teknologjisë së informacionit përfitojnë shtesën për natyrë të vecantë pune në masën dhe sipas kushteve të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.

*** Punonjësit në pozicionet specialist arkiv, përfitojnë një shtesë për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin sipas kushteve dhe masës së përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.

**** Përfitimet për kushtet e vështira e të dëmshme të shëndetit për punonjësit mbështetës janë sipas përcaktimeve në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore.

Struktura organizative e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit 2023

